



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 374/3_prot.

Pukë, më 28.02.2025

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
datë 25.02.2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesise së keshillit nr. 6 date 16.01.2025, mbledhja e radhes e keshillit te Bashkise Puke u zhvillua më datën 25.02.2025, ora 14⁰⁰ tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend-dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 22.01.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2025.
3. Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
4. Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësive administrative, Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"
5. Rishqyrtim i VKB nr.55 datë 03.12.2024 " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"
6. Projekt-vendim "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"
7. Projekt-vendim : " Për një shtesë në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"
8. Të tjera.



Ne mbledhje moren pjese: Kryetari i Bashkise , z. Rrok Dodaj, zv/kryetari , specialistja e Finaces zj.Florida Laci, drejtori i burimeve njezore z. Sokol Gjoni, shefi i sektorit te pyjeve z. Edmond Prendi, shefja e sektorit te ndihmes ekonomike zj. Lavdie Terbuni. drejtorja e menaxhimit te territorit zj. Lindita Hyseni etj.

Mbledhja filloi ne oren 14:00 siç ishte njoftuar. Jane prezent ne mbledhje 9 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit te Bashkise z. Gjon Gjoka , i cili u prezantoi keshilltareve projekt-rendim e ditës te miratuar nga kryesia e keshillit.

Ne vijim u hodh ne votim rendi i dites **dhe u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 22.01 .2025 : Ne vijim u hodh ne votim procesverbali i mbledhjes se keshillit te dates 22.01.2025 dhe **u miratua me 9 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar 2025**. Me pas u diskutua dhe u hodh ne votim projekt- vendimi per miratimin e ndihmes ekonomike , duke përdorur deri ne 6% te buxhetit dhe **u miratua ndihma me 9 vota pro. 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

3. Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026" Pas sqarimeve perkatese te specialistes

Ne perfundim Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"

u hodh ne votim: **U miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.**

4. Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njërive administrative, Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"

Sqaron Sokol Gjoni : Eshte nje ndryshim i vogel , me ate qe eshte miratuar ne Tetor 2024. Jane shume pake , qe perfitojne nga ndryshimet qe jane bere. sepse kane perfituar ne Tetor 2024. Specifikisht perfitojne rojet e institucioneve arsimore rreth 4000 leke ne muaj , rritje page rreth 30 persona. Disa punonjes me funksione administrative perfitojne rreth 2000 leke rritje page. Eshte edhe nje punonjese tjeter , qe ne mungese te specialist per arkiven , duke qene se ishin planifikuar dy punonjes , por aktualisht eshte nje punonjese , te ciles i eshte shtuar paga 4000 leke ne muaj. Nuk kemi bere ndryshime te tjera nga Tetori 2024.

Ne perfundim u hodh ne votim dhe u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.

5. Rishqyrtim i VKB nr.55 datë 03.12.2024 " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"

Sqaron Edmond Prendi: Eshte i njejti projektvendim, qe eshte miratuar me pare nga keshilli, por qe nuk ka marre konfirmimin ligjor nga Prefekti per disa mangesi te vogla , por procesi ne tersi ka qene konform ligjit.

Pyetje nga keshilli: D. Asani: Pse nuk kane njesite e tjera plan menaxhimi? Sa ekonomi pyjore perfshin ky plan menaxhimi? Sa eshte mundesia per ta realizuar nje plan te tille edhe per njesite e tjera?

Ed. Prendi : Per te hartuar nje plan menaxhimi kerkohen specialiste dhe preokupim I zyres per nje vit , duke lene te gjitha punet e tjera te zyres . Ky plan perfshine ekonomine pyjore Gomsiqe , pra njesine administrative Qerret dhe nje pjese te Pukes.

B. Aliaj : A ka plane te tjera te miratuara? Eshte edhe nje plan I Lumit te Zi , por nuk eshte miratuar per mangesi.

Rr. Doda (kryetari i bashkise) Pa plan menaxhimi nuk ka investime.Kur kerkon investime per hartimin e nje plani menaxhimi, sepse eshte shume I kushtueshem. Pra perfimi i fondeve eshte I lidhur me hartimin e planit te menaxhimit. Ky plan pasi merr konfirmimin ligjor ne prefecture, duhet te miratohet ne Ministrine e linjes dhe pas miratimit realizohet zbatimi i tij. Per hartimin e ketij plani eshte punuar mire dhe me perkushtim , eshte realizuar pa shpenzime vetem nga specialistat e sektorit.

Ne te gjithe Shqiperine jane vetem tre bashki , qe kane hartuar plane te tilla.. Une e kam bere problem tek Ministri.

D. Asani: Ky plan duhet te miratohet, pop se nuk bejme plane te tjera?

B. Aliaj : Duhet te tjetersohet fondi per dicka tjeter dhe jo per hartimin e planeve te menaxhimit?

Rr. Dodaj: Do te mundohemi qe te marrim zjarrefikse me sa me pak shpenzime.

Ne jemi nder bashkite ne vemendje per te bere plane menaxhimi. Dhe per te siguruar fonde per investime ne Pyje.

Hidhet ne votim dhe u miratua me 9 vota pro , 0 vota kunder, dhe 0 vota abstenim

6. Projekt-vendim "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"

Sqaron : Lavdie Terhini Behet fjale per familjet , qe nuk perfitojne nga pikezimi per sipas ketyre kritereve do te perfitojne nga perdorimi i 6% te fondit te pergjithshem.

D. Asani Ne menyre qe te perfshihen te gjitha familjet, qe kane nevoje , te kete edhe kriteret e tjera perfituese ?

A. Guga: Pse te perjashtohet edhe ndonje familje tjeter me probleme ekonomike ?

Gj. Gjoka : Ju lutem punoni me njerezit , qe te mos gabojne gjate aplikimit , qe te perfitojne sa me shume familje te varfera .

L. Terbuni : Njerezit jane shume indiferent dhe nuk interesohen per plotesimin e dokumentave.

A. Guga : Njerezit jane trembur nga pikezimi dhe nuk plotesojne dokumentacionin per ndihme, ne na intereson qe qytetaret te plotesojne dokumentacionin dhe te perfitojne ndihmen, por duhen sqaruar dhe ndihmuar. Sa Eshte numri i perfituesve dhe a ka persona te shtuar? Po nga 6% sa perfitojne?

Rr. Doda: Te gjithet e kane te mundur te bejne aplikimin, zyra eshte ne dispozicion.

Rrok Doda: Kam fisa informacione te mira: Me fondin shqiptar te zhvillimit do te kemi financime me baze materiale rreth 400-500 milion leke baze materiale. Do te jemi te angazhuar per realizimin e ketyre nderhyrjeve . Baza materiale , ndersa puna do te realizohet nga Bashkia.

D. Asani : E falenderojme kryetarin per kete lajme te mire , ne do te rishikojme buxhetin nese ka mbivendosje fondesh.

Rr. Doda : Kena perfituar dhe financimin e investimit ne hyrjen e qytetit deri te shkolla e mesme , po me fondin shqiptar te zhvillimit.

U hodh ne votim dhe u miratua me 9 pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.

7. Projekt-vendim : " Për një shtesë në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"

Sqaron : Specialistja e finances. Eshte kaluar ne komisionin e ekonomise. Sqaron detajet pas rakordimit me degen e thesarit per fondet e trasheguara nga viti 2024 dhe perdorimin e tyre .

D. Asani : Duhet rishikuar fondet e sherbimeve publike nese ka mbivendosje..

U hodh ne votim dhe u miratua me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim .

8. Te Tjera: Gj. Gjoka : Kemi disa kerkesa nga qytetaret , po keshtu nje nje raport per punen e keshillit gjate vitit 2024. Raporti e ka cdo keshilltar ne dosje. Nese kerkohen sqarime.

Kerkese per zgjerimin e varrezave ne Gjegjan.

Rr. Doda : Do te dergojme punonjesit tane dhe do te prezantojme ne keshill problemin e zgjerimit te varrezave ne Gjegjan.

Gj. Gjoka : Te shkoje nje grup pune per verifikim ne terren dhe te paraqitet ne keshill. Grupi i punes te kete perfaqesues nga urbanistika, njesia administrative, kryesia e fshatit dhe keshilli, grupi i punes mund te ngrihet nga kryetari i Bashkise.

Rr. Doda : Beni nje komision , qe te jete edhe per ne Puke, pasi eshte e nevojshme edhe ne Puke, ne do te japim sygjerimet tona.

N. Lalaj: Te gjitha varrezat kane nevojte per nderhyrje e riparime. Psh. Varrezat e Kalivares jane shume te vjetra dhe patjeter kane nevojte per riparime , se ato jane historia e zones. Ne gjegjan eshte e lehte nderhyrja , sepse vete banoret jane te interesuar dhe nuk besoj se ka konflikte. Per fondin me baze materiale ju lutemi nga ndihmoni me kazane mbeturinash dhe materiale te tjera , se jane te demtuara.

Gj. Gjoka : Ta bejme nje komision te perbashket per te verifikuar gjendjen reale.

A. Guga : Pse me ngrit grup pune. Ne gjegjan e ka pa kryesia e fshatit.

Gj. Gjoka : Komisioni do te nxise per te marre masa permiresuese.

Rr. Doda : Pse nuk e keni derguar kerkesen ne Njesi Administrative fillimisht?

Leke Luka : Kryetar i fshatit Gjegjan: Dua me permiresu kete problem.

N. Lalaj : Kerkesa eshte legjitime , nese nuk ka probleme e konflikte.

Kerkese e Dila Pjeter Prendit: Kryetari i keshillit lexoi kerkesen, ne kerkesa theksohet se kjo qytetare ka burrin e mashuar, vete eshte e moshuar . po ka edhe kunatin e moshuar dhe te paafte fizikisht e me probleme shendetesore dhe kerkon ta dergoje te misioni i motrave te Nene Terezes , por sipas ato i kane kerkuar nje vendim keshilli.

Gj. Gjoka: Zyra sociale ta verifikoje rastin dhe pas verifikimit te sjell ne keshill nje projektvendim.

Kerkesa per Rruge e z. Gjon Prendi, nga Kalivarja: U lexua kerkesa dhe njohen me permbajtjen e saj.

Rr. Doda: Me te drejte kerkon nje rruge dhe nje ure , por ka probleme sociale. Ne jemi dakord me bere por eshte konflikti , qe pengon, kerkohet demshperblim per pronen. Eshte problem hapja e rrugeve te reja., jo pa qellim kam kerkuar , qe keto rruge te futen ne planin e emergjencave, qe po hartojme.

D. Asani : Si mund ta zgjidhim kete problem?

N. Lalaj : Eshte kerkuar prej vitesh. Konflikti eshte i vjeter dhe nuk eshte arrit te behet. Duhet pa a eshte ne tapi ajo rruge dhe duhet te hapet.

Rr. Doda: Nje falenderim per punen e bere nga keshilli.

~~Duhet pa a është me tu...~~
~~... dhe duhet të hapet.~~
~~Rz. Dedej: Falenderim për punën e bërë.~~

Besmirë Aliq
~~...~~
Dritan Hasan
~~...~~
Arben Jugu

Aleksander Frenku
~~...~~
Shpresa Pemaq

Leze Kolaj
~~...~~
Ndue Kolaj









Besor Ruci

Gjon Çokor
~~...~~

sekretari i kështjës
Harzi Ferri
~~...~~



Lista e këshilltareve ne mbledhjen e dates : 25.02 .2025

Emri	Mbiemri	Firma	Verejtje
1.Gjon	Gjoka		
2. Enver	Sulejmani		
3. Ndue	Lalaj		
4. Arben	Gugaj		
5. Besmira	Aliaj		
6. Shpresa	Pemaj		
7. Edmond	Luka		
8. Alfons	Gjergjaj		
9. Dritan	Asani		
10. Besar	Kuçi		
11.Aida	Cenaj		
12.Aleksander	Frroku		
13. Eduard	Gjoka		
14. Alban	Lleshi		
15. Leze	Kolaj	